



Pranimi / Dated Priljezi / Prodaja Receipt / Delivery	15-03	702	3	vit god year
Organ / Istitucia Organ / Institution	Nr. Prot Pr. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2721/2023		116	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.399/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.399/2023 të datës 22.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 15.03.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.399/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 15.02.2023 i nxjerrë nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 02.11.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 23.11.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore me numër të referencës RN00010341 lidhur me pozitat për "Inspektor i Arsimit" në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës, për vendet e punës si në vijim: Ferizaj tri (3) pozita, Gjakovë katër (4) pozita, Gjilan tri (3) pozita, Mitrovicë tri (3) pozita, Prishtinë dy (2) pozita, Prizren tri (3) pozita dhe Pejë tri (3) pozita.

Ankuesi me datën 02.12.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë rekrutimi ka qenë i përfshirë deri në fazën e testimit me shkrim, meqë me datën 15.02.2023 Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme ka shpallur njoftimin lidhur me anulimin e kësaj procedure.

I pa kënaqur me anulimin e konkursit për pozitën *Inspektor i Arsimit* nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesi me datën 22.02.2023, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1991/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit të datës 20.02.2023 nga kjo e fundit, me pretendimet ankimore që Këshilli të merr vendim dhe të obligoj Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme që të vazhdoj me procedurën e rekrutimit ngase konkursi është anuluar pa bazë ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 01.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa me datën 14.03.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:1991/2023 të datës 22.02.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursin me numër të referencës RN00010341 të datës 02.11.2022; Njoftimin e datës 15.02.2023 të Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin Nr.252/2023 të datës 09.02.2023 nga Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore; Njoftimin e datës 24.01.2023 për listën e ngushtë nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB; Vendimin Nr.prot.2329 të datës 21.12.2022 lidhur me shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit paraprak për procedurën e rekrutimit për pozitën e nivelit profesional; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.03.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.03.2023 nga Ministria e Punëve të Brendshme-DMZP së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Vendimin Nr.15/99 të datës 30.09.2022 mbi emërimin e komisionit të pranimit; Njoftimin e datës 06.01.2023 lidhur me listën e ngushtë; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Aplikacionin e ankuesit të datës 02.12.2022 së bashku me dëshmitë mbi përvojën e punës, profesionale, dy vlerësimet e fundit, certifikatat mbi trajnimet, kopjen e letërnjoftimit si dhe certifikatën mbi evidencën penale; E-mailin zyrtar të datës 27.02.2023 me numër protokollit 2138/2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe E-mailin zyrtar të datës 03.03.2023 me numër të protokollit 2298 nga Departamenti për menaxhimin e Zyrtarëve Publike-MPB.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist të Shkencave Shoqërore”, i shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, sipas konkursit me numër të referencës RN00010341 lidhur me pozitën “Inspektor i Arsimit” në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës, kanë qenë si në vijim:

- Kualifikime/trajnime të posaçme nga fusha perkatëse profesionale;
- Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve themelore dhe postdiplomike 300 kredi/ECTS, (MA, MSC, MR) në fushën arsimore ose juridike;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku pesë (5) vite pervojë pune në fushën arsimore ose juridike;
- Te mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit dhe
- Të mos jetë i dënuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit dhe zhvillimit të procedurave të rekrutimit deri në fazën kur ankuesi ka parashtruar ankesë, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.2, Kodi i grupit 14. Gr. të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për secilën kategori të shërbimit civil, konkretisht për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore fusha e kërkuar e arsimit është: Ekonomik (pa specifikim), Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të tjera të ngjashme, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 02.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010341 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore, nga Ministria e Punëve të Brendshme, janë përfshirë vetëm drejtimit nga fusha arsimore ose juridike dhe nuk janë përfshirë drejtimit në fushat tjera siç përcaktohen tek grupi i 14 në shtojcën Nr.2 të kësaj rregulloreje. Kolegji i Këshillit ka analizuar po ashtu dispozitat e kësaj rregulloreje, konkretisht tek shtojca Nr.1/8 e së njëjtës është i sqaruar përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, ku si kërkesa të përgjithshme formale tek fusha e Arsimit të kërkuar janë përcaktuar: “Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor), ndërsa sipas kriterëve i shpallur nga ana Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me fushën e Arsimit të kërkuar për pikët e kredive të fituara janë kërkuar: “... 300 kredi/ECTS, (MA, MSC, MR)...”, andaj mbi këtë bazë edhe ka konstatuar se me rastin e mos përfshirjes së fushës së arsimit “Ekonomik (pa specifikim)”, Sociologji, Antropologji, Filozofi, Histori, Shkenca Politike, Psikologji, Punë Sociale e të tjera të ngjashme”, si dhe pikët e kredive si kriter i konkursit për emrin e grupit Specialist të Shkencave Shoqërore lidhur me pozitën “Inspektor i Arsimit” siç përcaktohet me dispozitat e kësaj rregulloreje për klasën e pozitës Profesional 1, Ministria e Punëve të Brendshme, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 ku përcaktohet se: “Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativo-teknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave

*përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive” si dhe në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 ku përcaktohet se: “Parimet e pranimit dhe avancimit në karrierë: Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”.*

Po ashtu Kolegji i Këshillit ndërlidhur me kriteret e shpalljes së këtij konkursi tek fusha e përvojës së punës e kërkuar, ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.1/8 e kësaj rregulloreje është i sqaruar përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, ku si kërkesa të përgjithshme formale tek përvoja e punës së kërkuar lidhur me këtë pozitë janë përcaktuar: “Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punë”, ndërsa tek kërkesat e përgjithshme formale sipas kushteve të konkursit i shpallur me datën 02.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010341 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore, nga Ministria e Punëve të Brendshme tek fusha e përvojës së punës së kërkuar janë përcaktuar: “Së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën arsimore ose juridike”. prandaj bazuar në këtë situatë Kolegji konstaton se, me rastin e ndërrimit të kriterëve të konkursit lidhur me përvojën e punës për pozitën për të cilën është shpallur konkursi, Ministria e Punëve të Brendshme ka vepruar gjithashtu në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik konkretisht nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 si dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konkretisht nenin 4 paragrafin 2 të kësaj rregullore.

Kolegji i Këshillit në kuptim të përcaktimit të kriterëve të konkursit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me procedurën e rekrutimit në fjalë, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës konkretisht nenin 9 paragrafin 2 nën paragrafin 2.1, 2.2 dhe 2.3, me të cilin janë përcaktuar se: “2. Inspektorët e arsimit zgjedhën në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbimin Civil. Përveç kushteve të parapara me Ligjin për Shërbimin Civil, kandidatët duhet ti plotësojnë edhe këto kriterë: 2.1. të kenë së paku titull master (300 ECTS); 2.2. të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në arsim. 2.3. të mos ketë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit” dhe me këtë rast ka konstatuar se me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik datë 09.07.2020 sipas Aktgjykimit Nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, neni 85 i këtij ligji ka përcaktuar që: “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj”, andaj mbi këtë bazë edhe kriteret e konkursit të jashtëm i shpallur me datën 23.11.2022 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore me numër të referencës RN00010341 lidhur me pozitën për “Inspektor i Arsimit” në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, është dashur të shpallen mbi bazën e dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkundër që shpallja është bërë sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërsa kriteret janë vendosë në bazë të Ligjit Nr.06/L-046 për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, kolegji i këshillit konstaton se në kohën kur është shpallur ky konkurs përkundër që ka qenë në fuqi Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, por se i njëjti ligj ka shfuqizuar çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj, e mbi këtë bazë edhe shpallja e konkursit që është objekt i kësaj ankese konsiderohet se është në

kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe kriteret që parashihen në Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit në Këshill e të cilat lidhen me anulimin e konkursit në fjalë, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se me datën 15.02.2023 Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ka shpallur njoftimin lidhur me anulimin e kësaj procedure pa dhënë arsye dhe specifika se përse i njëjti është anuluar. Për të sqaruar këtë situatë, Këshilli me datën 27.02.2023 përmes e-mailit zyrtar me numër protokolli 2138/2023 ka kërkuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme konkretisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të na njoftoj lidhur me atë se, citoj :*“Meqenëse shkresa mbi anulimin e këtij konkursi, nuk përmban te dhëna se mbi bazën e te cilave shkaqe është anuluar i njëjti, kërkojmë nga ana juaj te na njoftoni ndërlidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e kësaj ministrie për shkaqet dhe arsyetimet se mbi bazën e te cilave është anuluar ky konkurs, pasi që në Këshill përveç ankesës se lartcekur (ankesës se ankuesit ne fjalë) lidhur me këtë procedure kemi pranuar edhe ankesa tjera qe lidhen po me këtë çështje”,* ndërsa kjo e fundit me datën 03.03.2023 përmes e-mailit zyrtar i protokolluar në Këshill sipas shkresës numër 2298/2023, ka dhënë sqarimin si në vijim, citoj: *“ Sipas kërkesës suaj, ju njoftojmë se anulimi i konkursit për grupin Specialist të Shkencave Shoqërore....., ka ndodhur për shkak të gabimeve përmbajtjesore në kriteret e konkursit, për këtë arsye është parë e nevojshme të anulohet kjo procedurë”.* Si rrjedhojë Kolegji konstaton se anulimi i konkursit të jashtëm të datës 23.11.2022 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore me numër të referencës RN00010341 lidhur me pozitat për *“Inspektor i Arsimit”* në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës, nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, është i drejtë për faktin që sipas shkresës së datës 03.03.2023 konfirmohet rrethana se anulimi është bërë për arsye të gabimeve përmbajtjesore në kriteret e konkursit edhe pse ky organ nuk ka specifikuar saktë cilat kriteret nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi, por se bazuar në at që u potencua më lartë në arsyetim të këtij vendimi kolegji i këshillit sipas detyrës zyrtare është kujdesur që të konstatoj saktë arsyet ligjore se ky konkurs është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe akteve nënligjore që ndërlidhen me këtë objekt të kësaj ankesë ,e që mbi këto arsye kolegji konstaton se anulimi është bërë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, kështu që edhe pretendimet ankimore të ankuesit në drejtim të anulimit të kësaj procedure tanimë janë të pabazuara në kuptim të ligjshmërisë së kësaj procedure lidhur me kriteret e konkursit në fjalë.

Poashtu kolegji i këshillit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për të qartësuar faktet relevante që ndërlidhen me këtë objekt të ankesës ka konstatuar se ka pasur një konkurs të brendshëm në lidhje me këto pozita dhe at konkursi sipas datës së njoftimit 16/08/2021,në të cilin konkurs kanë qenë vetëm tri pozita të Inspektorëve të Arsimit dhe se ishin paraparë kriteret e përgjithshme formale të ndryshme nga kriteret që janë aplikuar në këtë konkurs duke përfshi edhe numrin e pozitave andaj kolegji konstaton se edhe kjo është një nga arsyet që ky konkurs është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë këtë çështje që lidhet me përmbajtjen e këtij konkursi.

Andaj, Kolegji Për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtrua nga palët në procedurë si dhe analizimit të dispozitave ligjore lidhur me kushtet dhe kriteret e pranimit në shërbimin civil, duke marrë për bazë edhe konstatimet e pasqyruara si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se konkursi i shpallur me datën 02.11.2022 sipas numrit të referencës RN00010341 për emrin e grupit Specialistë të Shkencave Shoqërore nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme-Departamenti për

Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë lidhur me pozitat "Inspektor i Arsimit" në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektorati i Arsimit të Kosovës, është bërë në kundërshtimin me nenin 4 paragrafin 2 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafin 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik .

Në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda,A.nr.399/2023, datë 15/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/MPB;
- Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit-DMZP/MPB
- Arkivit të KPMSHCK-së.